

VENDIM
Nr.182, datë 31.10.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCAVE TË DISA SUBJEKTEVE RTV

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", si dhe të kërkesave të subjekteve të interesuara, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

V E N D O S I:

1. Në mbarim të afatit të licencimit të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektet:

- "Club Muzikor" sh.a. për radion "Club FM";
- "Top Gold sh.p.k për radion "Top Gold";
- "Pelari / A" sh.p.k për radion "Fieri";
- Z.Spiro Zguri për radion "Magic Star";
- Z.Robert Hoxha për radion "Val'e Kaltër";
- Z.Eno Alimerko për radion "Ime";
- "Alfa dhe Omega" sh.p.k për radion "Alfa & Omega".

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2003 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela